



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë - Albania,

Tel/Fax: 04 2268141; 042268142

Nr. 36/6 Prot.

Tiranë, më 09.02.2016

V E N D I M

Nr. 18, datë 09.02.2016

Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjës ***,
pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e verifikimit të rastit të transferimit të punonjës ***** , pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave,

Vërej se:

Me urdhrin nr. 36/1, datë 22.01.2016, "Për verifikim informacioni", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesin e verifikimit të rastit të transferimit të punonjës ***** , pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave.

Ndërkohë, me shkresën nr. 384/1 prot., datë 03.02.2016, "Kthim përgjigje", Departamenti i Administratës Publike, ka informuar Komisionerin, se pranë këtij institucioni është depozituar një ankim, ku pretendohet se punonjësja ***** nuk plotëson kriterin e nivelit të arsimit në pozicionin ku është transferuar, për shkak të ristrukturimit dhe se ky rast është duke u shqyrtuar.

Në këto rrethana, vlerësoj se procesi i verifikimit i nisur me urdhrin nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016, duhet të pezullohet dhe Departamenti i Administratës Publike, në përfundim të shqyrtimit të rastit të

transferimit të punonjësës ***** pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave, duhet të informojë Komisionerin në lidhje me përfundimin e çështjes.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 78 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të rastit të filluar me urdhrin nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016, në lidhje me transferimin e punonjësës ***** pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave, deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.
2. Departamenti i Administratës Publike të informojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, menjëherë pas përfundimit të procesit të shqyrtimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA